



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 234, Datë 19.07.2023

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË  
“HYDRO SETA” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1890/1 prot., datë 14.07.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDRO SETA” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “HYDRO SETA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1890 prot., datë 07.07.2023, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 5, datë 17.01.2019, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 18.01.2024
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 433 Seria T19, është 17.01.2024).
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas

Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “HYDRO SETA” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe nenin 16, pika 7.
- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Në këtë aplikim konstatohet mungesa e dokumentacionit/informacionit sipas nenit 16, gërma “c”, informacionin/deklarimin përkatës për ushtrimin e veprimtarisë.
- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brënda afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar..
- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të Rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 433, Seria T19, të shoqërisë “HYDRO SETA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**